



UDHËZUES PËR APLIKIM

Drejtoria e Policisë së Shtetit ka përgjegjësi që shtetasit të cilët aplikojnë për t'u pranuar në Akademinë e Sigurisë, për Shkollën Bazë të Policisë, të përzgjidhen në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe transparente, duke vlerësuar me të mirët. Përzgjedhja e aplikantëve bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve, standardeve të përcaktuara dhe renditjes sipas rezultateve të arritura gjatë procedurave të konkurrimit.

Qëllimi i botimit të këtij udhëzuesi është të informojë shtetasit që janë të interesuar për t'u pranuar në Akademinë e Sigurisë për Shkollën Bazë të Policisë për:

- **misionin e Policisë së Shtetit**
- **pagat dhe përfitimet**
- **përgjegjësitë, detyrimet dhe kufizimet**
- **kushtet e punës**
- **kriteret e domosdoshme për përzgjedhjen e aplikantit**
- **procedurat e aplikimit**
- **procedurat e testimit, metodat dhe standardet**
- **mundësitë për t'u ngritur në detyrë**

Misioni i Policisë

- Policia e Shtetit, në vijim Policia, ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Shërbimet Policore që ka Policia e Shtetit

Policia e Shtetit funksionon mbi bazën e shërbimeve policore, të cilat janë:

- Shërbimi i Hetimit të krimit
- Shërbimi i Policisë Shkencore
- Shërbimi i Rendit publik
- Shërbimi i Forcave lëvizëse operacionale (forca speciale)
- Shërbimi i Qarkullimit rrugor
- Shërbimi i Policisë kufitare e migracionit
- Struktura Ndihmëse, mbështetëse e të trajnimit

Pagat dhe përfitimet

Punonjësi i policisë, për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, ka përparësi në trajtimin financiar, ku përfshihen:

- paga mujore e punonjësit të Policisë përbëhet nga paga bazë, që është paga për gradë dhe nga shtesat për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesat për natyrë të veçantë pune;
- grada është e përcaktuar sipas funksionit të miratur me vendim të Këshillit të Ministrave;
- të gjitha shtesat e tjera të veçanta mbi pagë, si dhe shpërblimet që përfitojnë punonjësit e tjerë të administratës publike;
- kompesim për privacionet që i krijohen për largësi nga vendbanimi, sipas kostos së transportit publik dhe paga për papunësinë e bashkëshort/es;
- trajtimi me ushqim;
- përfitojnë çdo vit, në fund të vitit financiar, një shpërblim deri në një pagë mujore, të njëjtë me atë të përfituar nga punonjësit të administratës shtetërore. Ky shpërblim jepet në bazë të një shkalle përpjesëtueshmërie, që pasqyron kohën e punës së kryer nga punonjësi gjatë vitit financiar.
- punonjësit që nuk kanë mungesa në punë për çfarëdo arsye, përveç kohës së pushimit, kanë të drejtën e shpërblimit të plotë.
- Rregullimi i pagave, kriteret dhe përgjegjësitë për dhënien e tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përgjegjësitë

1. Përgjegjësitë e Policisë janë:

- mbron jetën, shëndetin, pronën publike dhe private;
- ruan rendin dhe sigurinë publike;
- parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me ligjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre;
- organizon fushata ndërgjegjësuëse dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun;
- koordinon punën me inspektoratet kompetente në fushën e ndërtimit, kontrollit të mjedisit dhe territorit, për marrjen e sanksioneve administrative dhe sanksioneve të tjera, sipas ligjit të tyre funksional;
- identifikon, siguron dhe trajnon në ambientet e saj, personat e arrestuar ose të ndaluar deri në caktimin e masës së sigurimit me vendim gjykate, si dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë në mungesë, deri në transferimin e tyre në institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale;
- mbikëqyr dhe drejton trafikun rrugor në rrugë për përdorim public, në përputhje me ligjislacionin rrugor;
- mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë;
- kontrollon regjimin e hyrjeve-daljeve të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;

- identifikon, mbron dhe referon për asistencë, pranë autoriteteve përkatëse, viktimat e trafikimit, të personave dhe dhunës në familje, veçanërisht të miturit dhe gratë;
- administron dhe mbron informacionin e klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacion;
- ruan dhe siguron personalitetet e larta shtetërore dhe të huaja, si dhe objektet e rëndësisë së veçantë;
- merr, trajton dhe/ose referon pranë strukturave përgjegjëse, ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë kallëzimet penale ose informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Detyrimet të përgjithshme

Punonjesi i policisë i policisë gjatë detyrës/shërbimit duhet të zbatojë detyrimet dhe normat e sjelljes si më poshtë:

1. Të zbatojë parimet, procedurat dhe rregullat mbi bazën e të cilave funksionon Policia.
2. Të realizojë detyrat sipas rëndësisë që kanë duke filluar nga mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve.
3. Të respektojë dinjitetin dhe integritetin e çdo punonjësi tjetër të Policisë, përfshirë edhe vartësit e tij.
4. Të zhvillojë kritikën ndaj eprorit, udhërave të tij apo punës në tërësi vetëm brenda institucionit të Policisë.
5. Të zbatojë procedurat e përcaktuara dhe linjën hierarkike në rastet e ankesave ndaj eprorëve.
6. T'i trajtojë në mënyrë të barabartë personat dhe të kryejë detyrat pa diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore.
7. Të kryejë veprimet e duhura kur konstaton shkelje të ligjit, për të cilat ngarkohet me detyra Policia e Shtetit, pavarësisht nga detyra që kryen apo vendi ku është caktuar të punojë në funksionet operationale.
8. T'i trajtojë kolegët dhe vartësit me mirësjellje dhe respekt, duke mënjanuar qëndrimin dhe fjalorin abuziv e fyes, si dhe të ndërtojë raporte të drejta me eprorët.
9. Të veprojnë me ndershmëri dhe paanshmëri në marrëdhënie me eprorët, personat dhe kolegët e tyre.
10. T'i ofrojë të gjitha shërbimet e mundshme çdo personi që kërkon informacion apo ndihmë në përputhje me parimet, rregullat dhe procedurat e punës së Policisë.
11. Të kujdeset që personave të sëmurë apo të plagosur t'u ofrohet përkujdesje mjekësore.
12. Të mbajë uniformën në mënyrën e përcaktuar në aktet normative.
13. Të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e Policisë vetëm gjatë kryerjes së detyrës, ose në raste ceremonish kur përfaqëson Policinë e Shtetit.
14. Të mos japë informacione policore dhe/ose të klasifikuara, për të cilat ka marrë dijëni gjatë kryerjes së detyrës ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme.
15. Të administrojë dhe të ruajë nga çdo dëmtrim armatimin, pajisjet dhe mjediset që i janë dhënë në përdorim për ushtrimin e detyrës dhe plotësimin e kushteve të punës dhe të jetesës.

16. T'u bindet urdhrave të eprorëve në linjën hierarkike dhe të kryejë detyrat e dhëna në përputhje me ligjin.
17. Urdhri që jepet nga eprori për punonjës në detyrë/shërbim në zbatim të legjislacionit, i shkruar ose verbal, duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm, në përputhje me etikën policore dhe në dobi të kryerjes së detyrave.
20. Të ndihmojë çdo punonjës tjetër gjatë ushtrimit të detyrës, kur vlerëson se ai ka nevojë për ndihmë, me përjashtim të rasteve kur kjo ndihmë refuzohet. Në rastet kur punonjësi që ofron ndihmën e tij është në shërbim, ai është i detyruar të vlerësojë dhe zbatojë përparësinë në kryerjen e detyrës.
21. Të tregohet i sinqertë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me detyrën/shërbimin, duke përfshirë edhe kohën prej datës së aplikimit në shërbim.
22. Të përdorë armët e zjarrit në përputhje me ligjin dhe me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.
23. Të vishet në mënyrë të përshtatshme gjatë kryerjes së detyrës/shërbimit, kur nuk kërkohet mbajtja e uniformës.
24. Të përdorë forcën në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit.

Kufizime të përgjithshme të punonjësit

Gjatë kryerjes së detyrës/shërbimit, për shkak të saj, ose jashtë kryerjes së detyrës/shërbimit punonjësit i ndalohe:

1. Të jetë anëtar i një partie politike ose organizatë politike.
2. Të mbështesë fushatën e një partie, organizatë politike, të një anëtari partie politike apo të një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht ose financiarisht.
3. Të kryejë detyrën e ndikuar nga bindjet e tij politike ose nga interes personale ose shoqërore.
4. Të përdor pronën e Policisë, si dhe mjeteve e pajisjeve të saj gjatë zhvillimit të fushatave politike,
5. Të punësohet ose kryejë veprimtari tjetër private, me përjashtim të mësimdhënies.
6. Shfrytëzimi i autoritetit policor, për qëllime që nuk lidhen me ushtrimin e funksionit dhe të detyrave policore.
7. Përdorimi i pijeve alkoolike kur është në detyrë/shërbim ose kur është me uniformë, përveç rasteve për kryerjen e detyrave të veçanta.
8. Shoqërimi apo qëndrimi me persona, për të cilët duhet të ketë dijeni për shkak të funksionit, se janë persona me precedentë kriminalë dhe të qëndrojnë në vendet ku dihet se qëndrojnë persona të tillë, me përjashtim të rasteve kur është caktuar në detyrë.
9. Diskutimi me median apo me persona të tjerë për çdo lloj informacioni që lidhet me zbulimin e veprave penale pa lejen e eprorit apo autoritetit zyrtar përkatës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.
10. Dhënia personave të paautorizuar e informacioneve policore që disponojnë ose me të cilat njihen për shkak të detyrës si dhe mundësimi i dhënies së këtyre informacioneve personave të tjerë, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

11. Pranimi i shpërblimit në të holla ose në mënyra të tjera, të dhuruar si rezultat i çfarëdo shërbimi, ose për shkak të tij.
12. Mbajtja apo përdorimi i dokumentit identifikues si punonjës të pamiratur nga autoriteti përkatës.
13. Përdorimi i substancave të paligjshme.
14. Përdorimi i armëve të tjera gjatë apo pas kryerjes së detyrës/shërbimit.
15. Pirja e duhanit në ambiente të ndaluara me ligj si dhe gjatë shërbimit.
16. Përdorimi dhe shfrytëzimi i korrespondencës zyrtare për qëllime private.
17. Paraqitja në detyrë/shërbim në gjendje të dehur ose nën efektet e substancave stimuluese me përjashtim të rasteve të rekomanduara nga mjeku.
18. Kryerja e veprimeve të pahijshme, denigruese dhe turpëruese për policinë.

Kushtet e Punës

1. Punonjësi i policisë kryen 40 orë shërbim në javë dhe ka të drejtën e pushimeve javore, pushimeve të festave zyrtare si dhe të lejes së zakonshme që varion nga 30 deri në 40 ditë kalendrike, sipas gradës që mban.
2. Nëse punonjësi i policisë thirret për të kryer detyra në kohën e pushimit, kjo kohë i zëvendësohet me pushim në një ditë tjetër, ose në pamundësi të pushimit kjo kohë i paguhet sipas rregullave të përcaktuara në ligj.
3. Policia u siguron punonjësve të saj kushte të përshtatshme pune në ambientet e saj si në stacionin e policisë, në komisarariat, në drejtorinë vendore të policisë si dhe në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.
4. Për kryerjen e detyrave operacionale dhe të kontrollit të territorit, policia vë në dispozicion punonjësve të saj mjete lëvizëse, mjete të ndërlidhjes si dhe pajisje të tjera në funksion të detyrave që do të kryhen.
5. Për kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet që ka, punonjësi i policisë lidh kontratë me punëmarrësin.

Kriteret për pranim në Akademinë e Sigurisë

1. të jetë shtetas shqiptar;
2. të mos jetë i përjashtuar nga policia apo të jetë larguar nga shërbimi civil;
3. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
4. të jetë në gjendje të mire shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;
5. të ketë mbaruar shkollën e mesme;
6. të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
7. të mos jetë i dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
8. të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të drejtimit të automjetit të tipit B

Procedurat e Aplikimit

Procedura e aplikimit për pranim në Akademinë e Sigurisë, për Shkollën Bazë të Policisë, fillon kur aplikanti dorëzon në strukturat vendore të burimeve njerëzore ku ka

vendbanimin e përhershëm, formularin e aplikimit të plotësuar së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

Me marrjen e formularit të plotësuar, Drejtoria vendore e Policisë i lëshon aplikantit një dokument që vërteton marrjen e aplikimit. Drejtoria e Policisë në Qarqe hartojnë listën e aplikantëve që plotësojnë kriteret dhe përgjigjen për dërgimin e saj në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Procedurat e testimit, metodat dhe standardet

Aplikantët e përzgjedhur për të vazhduar procesin e pranimit i nënshtrohen fazave dhe procedurave të konkurrimit sipas rendit të mëposhtëm:

- a) testi me shkrim;
- b) testi i aftësive fizike;
- c) intervista me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testit të aftësive të shkruarit;
- ç) testit psikologjik;
- d) kontrolli shëndetësor;
- dh) marrja e shenjave të gishtave;
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit;

a) testi me shkrim

1. Testi shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të Policisë. Aplikantit i kërkohet të lexojë, të analizojë dhe të kuptojë gjuhën standarde shqipe. Testi me shkrim administrohet dhe vlerësohet me pikë nga Akademia e Sigurisë. Në përfundim të testit me shkrim, Akademia e Sigurisë publikon zyrtarisht në faqen zyrtare të internetit të Policisë së Shtetit, listën e rezultateve të testit me shkrim.

2. Rezultatet e testit me shkrim dalin brenda së njëjtës ditë kur zhvillohet testimi. Aplikantët që kanë arritur të marrin kufirin minimal të pikëve të përcaktuar nga Drejtori i Policisë së Shtetit për kalimin e testit me shkrim, njoftohen për të vazhduar procesin e testimit.

3. Aplikantët që nuk arrijnë të marrin pikët e nevojshme të testit me shkrim nuk kalon në fazën tjetër të konkurrimit sipas rendit të përcaktuar.

b) testi i aftësive fizike

1. Aplikantët që kalojnë testin me shkrim, duhet të kalojnë testin e aftësive fizike, që teston aftësitë psikomotore ku përfshihet:

- shpejtësia,
- shkathtësia fizike,
- rezistenca,
- forca muskulare
- koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të Policisë.

2. Testi i aftësive fizike vlerësohet sipas standardit të përcaktuar në kohën e zhvillimit të testit.

3. Testi fizik për Shkollën Bazë të Policisë përbëhet nga pesë komponent:

- Kërcim Vertikal
- Ushtrime për barkun një minutë
- Maksimumi i mundshëm pompash
- Vrap 300 metra
- Ecje/Kros 2.4 km

4. Normat për kalimin e këtij testi janë të ndara veç për femrat dhe për meshkujt dhe sipas grup moshave.

5. Aplikanti duhet të marrë minimumin e mundshëm të pikëve për të vazhduar fazën tjetër atë të intervistën me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të shkruarit.

c) intervista me gojë

1. Qëllimet e intervistës me gojë janë të vlerësojë:

- a. aftësitë e aplikantit për të menduar, analizuar, komunikuar dhe marrë vendime;
- b. aftësitë e aplikantit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;
- c. përshtatshmërinë e aplikantit për t'u bërë punonjës Policie

2. Komisioni i Intervistës i bën aplikantit pyetje të strukturuar, të cilat nuk kërkojnë njohuri paraprake të teknikave apo praktikave policore. Pyetjet testojnë aftësitë e aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar dhe marrë vendime.

3. Komisioni kryen intervistën me gojë në përputhje me udhëzimet e përcaktuara dhe vendos për secilin aplikant rezultatin numerik bazuar në një mekanizëm të miratuar vlerësimi.

ç) kontrolli psikologjik

Kandidatët e përzgjedhur i nënshtrohen kontrollit psikologjik nga psikologë të licensuar për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre nga pikëpamja psikologjike për të kryer detyrat e punonjësit të Policisë.

d) kontrolli mjekësor

1. Aplikantët e përzgjedhur i nënshtrohen kontrollit shëndetësor nga komisioni mjekësor i ngritur për këtë qëllim.

Shpenzimet e kontrollit mbulohen nga kandidati.

2. Llojet e ekzaminimeve, kriteret dhe procedurat për kontrollin shëndetësor përcaktohen në Procedura standarde të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

dh) marrja e shenjave të gishtave dhe mostra e AND

1. Aplikantëve të përzgjedhur u merret mostra e ADN-së, si dhe shenjat e gishtave sipas procedurave standarde të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

2. Shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së e të gjithë punonjësve të Policisë ruhen në një bazë të veçantë të dhënash në Drejtorinë e Policisë Shkencore.

d) verifikimi përfundimtar i aplikantit

1. Aplikanti i përzgjedhur i nënshtrohet procesit të verifikimit përfundimtar, për të dokumentuar faktin që ai, ose pjestarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale. Për këtë bëhet verifikimi i:

a) të dhënave të paraqitura në formularin e aplikimit;

b) dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti;

c) të dhënave të cilat e implikojnë aplikantin në veprimtari kriminale, sjellje antishoqërore apo veprimtari të tjera të kundraligjshme.

Rastet për skualifikim

1. Aplikanti skualifikohet në rastet e mëposhtme:

a. nuk kalon testimin me shkrim;

b. nuk kalon testimin e aftësive fizike;

c. nuk kalon kontrollin psikologjik;

ç. nuk paraqitet në kohën e caktuar në një nga fazat e testimit;

d. ka deklaruar të dhëna të rreme apo ka paraqitur dokumente të falsifikuara;

dh. pas procesit të verifikimit përfundimtar, rezulton se ai ose pjestarë të familjes së tij janë të dënuar për vepra të rënda penale;

e. rezulton përdorues droge;

ë. rezulton të ketë varësi nga alkoli;

2. Aplikanti në rast se nuk kalon një nga fazat e konkurrimit, sipas rendit zbrirës të përcaktuar në nenin 135 të VKM-së nr. 750, datë 16.09.2015 "Për miratimin e Rrregullores së Policisë së Shtetit", humbet të drejtën për kalimin në fazën tjetër të konkurrimit dhe skualifikohet.

Pranimi në Polici

1. Aplikantët të cilët kalojnë me sukses fazat e konkurrimit, përfshihen në listën e kandidatëve për t'u pranuar në Akademinë e Sigurisë sipas pikëve të marra në rendin zbritës.

2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit listën e kandidatëve për t'u pranuar në Akademinë e Sigurisë, nga lista e përgjithshme sipas të pikëve të marra në rendin zbritës, gjatë procesit të testimit. Në rastet kur dy ose më shumë kandidatë rezultojnë me pikë të barabarta, do të merret për bazë rezultati i testit me shkrim.

3. Aplikanti i cili është skualifikuar sipas këtij udhëzuesi, ka të drejtë pas çdo faze konkurrimi të ankohet në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, brenda 2 ditëve nga

marrja e njoftimit për skualifikim. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave shqyrton dhe duhet të kthejë përgjigje brend 5 ditëve pune nga marrja e ankesës. Nëse rezultati i shqyrtimit është në favor të aplikantit, ai njoftohet menjëherë, por jo më vonë se e nesërmja e marrjes së vendimit, për të vazhduar procesin.

4. Me pranimin në Akademinë e Sigurisë, lidhet kontrata për ndjekjen e shkollës bazë të Policisë midis kursantit dhe titullarit të Akademisë së Sigurisë, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet respective.

Mundesitë e promovimit (ecuria në karrierë)

1. Ecuria në karrierë e punonjësit të Policisë nënkupton fitimin e gradës pasardhëse, nëpërmjet një procesi vlerësimi konkurrues.

2. Procesi i konkurrimit për fitimin e gradës bëhet vetëm për plotësimin e funksioneve të lira, sipas gradave.

3. Punonjësit e Policisë përzgjidhen për të ndjekur shkollim/trajnimin, duke u bazuar në listën emërore të së drejtës për fitim gradë, të hartuar pas procesit konkurrues, me rezultatet sipas rendit zbritës.

4. Punonjësit e Policisë fitojnë gradën vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses shkollim/trajnimin përkatës për atë gradë, në Akademinë e Sigurisë.

6. Gradën "Inspektor" i jepet punonjësit të Policisë pas përfundimit me sukses të shkollimit bazë të policisë.

7. Punonjësit të Policisë i lind e drejta të aplikojë për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes, pas plotësimit të kohës së qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:

- nga "Inspektor" në "Nënkomisar" 5 vjet
- nga "Nënkomisar" në "Komisar" 3 vjet
- nga "Komisar" në "Kryekomisar" 3 vjet
- nga "Kryekomisar" në "Drejtues" 5 vjet
- nga "Drejtues" në "Drejtues i Parë" 3 vjet

8. Kriteret dhe procedurat për konkurrim për fitimin e gradës janë të përcaktuara në VKM-në nr.750, datë 750, datë 16.09.2015 "Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit", si dhe në procedurat standarde të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.